



Në bazë të dispozitave të nenit 14 të Ligjit mbi token ndërtimore ("Gazeta Zyrtare. e Kosovës" nr. 4/80), dhe të nenit 32, pika 32.1, shkronja e të Statusit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2008, merr

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË POLICISË SË KOSOVËS

Neni 1

- 1.1 Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Policisë së Kosovës.
- 1.2 Lokacioni, nga paragrafi 1 i këtij neni, përfshin ngastrën kadastrorë nr. 2717/2, në sipërfaqe prej 0.43,09 ha, Zona kadastrorë -Prishtinë.

Neni 2

Ndërtimi i objektit, sipas këtij Vendimi, do të bëhet në bazë të programeve dhe përmbajtjeve tjera, të nevojshme për objekte me kësi destinomi, të hartuar nga organet kompetente të Komunës së Prishtinës.

Neni 3

- 3.1 Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.
- 3.2 Nga aspekti i realizimit të lokacionit do të kujdeset Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
- 3.3. Sektori i kadastrim do t'i kryejë veprimet procedurale të nevojshme nga përgjegjësia e tij për zbatimin e këtij Vendimi.

Neni 4

Pjesa përbërëse e këtij Vendimi është pjesë tekstuale dhe grafike e situacionit të lokacionit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. Nr.110-1023, më 16.7.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa